

**SHOQATA E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR
“HANDIKOS” FERIZAJ**

Raporti i Auditorit të Pavarur dhe
Pasqyrat Financiare për fund vitin
31 Dhjetor 2025

Mars, 2026

Përmbajtja:

Faqe

Raporti i auditorit të pavarur.....	3
Pasqyrën e pozicionit financiar.....	6
Pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.....	7
Pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet	8
Pasqyra e rrjedhës së parasë.....	9
Shënimet mbi pasqyrat financiare.....	10



“Eco&Conto” SH.P.K.
Kompani Ligjore e Auditimit
Rr. Vllëzërit Gërvalla Ferizaj
Mob. +383 44 219 208
Email: eco_conto@hotmail.com

RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR

Për menaxhmentin e :
SHOQATA E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR “HANDIKOS” FERIZAJ

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të OJQ **SHOQATA E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR “HANDIKOS” FERIZAJ** që përfshinë Pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2025, Pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, Pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe Pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që ka përfunduar, si dhe një përmbledhje të politikave të kontabilitetit dhe shënimeve tjera shpjeguese.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të OJQ-ës paraqesin drejtë, në të gjitha çështjet materiale pozicionin financiar të OJQ-ës më 31 Dhjetor 2025, dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin që ka përfunduar në përputhshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin e raportit Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga OJQ-ja në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodit IESBA), dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë.

Çështjet kryesore të auditimit

Çështjet kryesore të auditimit janë ato çështje që sipas gjykimit tonë profesionale ishin më të rëndësishmet në auditimin tonë të pasqyrave financiare në periudhën aktuale. Këto çështje u adresuan në kontekstin e auditimit tonë të pasqyrave financiare në tërësi dhe në formimin e opinionit tonë mbi të dhe Ne nuk shprehim një opinion të veçantë për këto çështje.



“Eco&Conto” SH.P.K.
Kompani Ligjore e Auditimit
Rr. Vllëzërit Gërvalla Ferizaj
Mob. +383 44 219 208
Email: eco_conto@hotmail.com

Përgjegjësitë e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me SNRF, dhe për kontrollin e brendshëm të cilat menaxhmenti i vlerëson të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së OJQ-ës për vazhdueshmërinë në të ardhmen, duke shpalosur, sipas nevojës, çështjet lidhur me vijimësinë në të ardhmen dhe përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit përveç nëse menaxhmenti synon të likuideojë OJQ-në apo të ndërpres operimin, apo nuk ka ndonjë alternativ tjetër të mundshme përveç se të bëjë atë. Ata të cilët janë ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të OJQ-ës.

Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë të lira nga gabimet materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrë një raport të auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk ka garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë gabime materiale kur ato ekzistojnë. Gabimet mund të rrjedhin nga mashtrimet apo gabimet dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në total, ato në mënyrë të arsyeshme mund të pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përshtatshme për këto rreziqe, dhe marrim dëshmi të auditimit të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të gabimeve materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë se atij që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrolleve të brendshme.
- I kuptojmë kontrollin e brendshëm relevante për auditim me qëllim të hartimit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të OJQ-ës.
- I vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjet relevante të bëra nga menaxhmenti.



“Eco&Conto” SH.P.K.
Kompani Ligjore e Auditimit
Rr. Vllezërit Gërvalla Ferizaj
Mob. +383 44 219 208
Email: eco_conto@hotmail.com

- Konkludojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit nga menaxhmentit, duke u bazuar në dëshmitë e siguruar të auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet apo kushteve që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e OJQ-ës për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet relevante në pasqyrat financiare apo, nëse shpalosjet e tilla janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit. Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personelin e ngarkuar lidhur me çështjet tjera, qasjen e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që kemi identifikuar gjatë auditimit. Ne komunikojmë me personelin e ngarkuar lidhur me çështjet tjera, qasjen e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që kemi identifikuar gjatë auditimit.

Raport mbi kërkesat e tjera ligjore dhe rregullative

Ne jemi angazhuar si auditor të OJQ SHOQATA E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR “HANDIKOS” FERIZAJ Për periudhën 01.01.2025- 31.12.2025 me datë 26.01.2026 nga drejtori I OJQ SH.P.A.K.-HK FR z. Evner Kosumi.

- a) Ne kemi dizajnuar procedurat e auditimit në mënyrë që t’iu përgjigjemi rreziqeve të identifikuar për të siguruar dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme dhe për të fituar siguri të arsyeshme lidhur me prezantimin e pasqyrave financiare dhe shënimeve shpjeguese.
- b) Ne deklarojmë që nuk kemi ofruar shërbime të ndaluara jo audituese të përmendura në nenin 5 të UA nr. 02/2019 dhe ne jemi të pavarur ndaj subjektit të audituar gjatë kryerjes së auditimit.

“Eco&Conto” SH.P.K.

Naser Qerimi

03 Mars, 2026

Rr. Vllezërit Gërvalla
70000 Ferizaj, Kosovë.



Deklaratë e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare vjetore për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2025

Në pajtueshmëri me vendimin e Drejtorit të SHOQATA E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR "HANDIKOS" FERIZAJ deklaronë se:

- a) Pasqyrat financiare dhe shënimet në faqet 10-18, janë në pajtueshmëri me Ligjin Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, Rregulloret dhe Urdhëresat Administrative të aplikueshme, përfshirë:
 - (i) Pajtueshmërinë me Standardet e aplikueshme Ndërkombëtare të Kontabilitetit përkatësisht, Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNK-SNRF) dhe
 - (ii) Paraqesin drejt dhe fer Pasqyrën e Pozicionit Financiar, Pasqyrën e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse, Pasqyrën e rrjedhës së parasë dhe ndryshimet në ekuitet të SHOQATA E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR "HANDIKOS" FERIZAJ me 31 Dhjetor 2025 dhe të performancës së saj për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2025.
- b) Sipas opinionit të Drejtorëve ka bazë të arsyeshme të besojmë se kompania do të jetë në gjendje të paguaj detyrimet e saj në momentin kur maturohen dhe bëhen të pagueshme.

E nënshkruar nga:


Drejtor ekzekutiv


Enver Kosumi

Data: 03 Mars, 2026



Menaxhere financiare


Zana Shabani

Pasqyra e Pozicionit Financiar
Periudha 01.01.2025 deri 31.12.2025

	Shënimi	Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025 €	Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2024 €
PASURITË			
Pasuritë afatshkurtra			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	1	39,348	15,042
Instrumentet financiare afatshkurtëra		-	-
Gjithsejt pasuritë afatshkurtëra		39,348	15,042
Pasuritë afatgjata			
Prona, pajisjet dhe impiantet	2	227,108	172,207
Prona investuese		-	-
Gjithsejt pasuritë Afatgjata		227,108	172,207
Gjithsejt pasuritë		266,455	187,248
DETYRIMET DHE EKUITETI			
DETYRIMET			
Detyrimet afatshkurtra			
Mbitërheqja bankare		-	-
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	3	583	584
Kreditë dhe huatë, pjesa afatshkurtër		-	-
Interesi I pagueshëm		-	-
Tatimi në fitim I pagueshëm dhe të tjera		-	-
Gjithsejt detyrimet afatshkurtra		583	584
Detyrimet afatgjata			
Kreditë dhe huatë, pjesa afatgjatë		-	-
Provizionet afatgjata		-	-
Gjithsejt detyrimet afatgjata		-	-
Gjithsejt detyrimet		583	584
EKUITETI			
Kapitali aksionar		-	-
Fondet e mbajtura	4	265,872	186,665
Rezervat e tjera		-	-
Gjithsejt ekuiteti		265,872	186,665
Gjithsejt ekuiteti dhe detyrimet		266,455	187,248


Të aprovuara të lëshuara nga menaxhmenti dhe të nënshkruara në emër të tij me 03 Mars, 2026

Drejtor ekzekutiv


 Enver Kosumi



Menaxhere financiare


 Zana Shabani

Shënimet shpjeguese nga faqe 10 deri në 18 janë pjesë përbërse e këtyre pasqyrave financiare

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse
Periudha 01.01.2025 deri 31.12.2025

	Shenimi	Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025 €	Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2024 €
Të hyrat nga donacionet	5	97,487	73,928
Kostoja e shitjes		-	-
Fondi Bruto		97,487	73,928
Të ardhurat tjera	6	58,899	129,096
Shpenzimet e shpërndarjes		-	-
Shpenzimet administrative	7	(76,631)	(87,728)
Shpenzimet tjera		-	-
Fondi/ (humbja) operativ		79,755	115,296
Shpenzimet financiare	8	(547)	(1,028)
Të ardhurat financiare		-	-
Fondi para tatimit		79,208	114,268
Fondi I bartur		-	-
Shpenzimet e tatimit në fitim/humbjet e bartura		-	-
Fondi i vitit	9	79,208	114,268

Shënimet shpjeguese nga faqe 10 deri në 18 janë pjesë përbërse e këtyre pasqyrave financiare

Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet
Periudha 01.01.2025 deri 31.12.2025

	Fitimet e mbajtura	Gjithsej
	€	€
Gjendja me 01 Janar 2024	72,397	72,397
Fitimi / (humbja) i/e vitit	114,268	114,268
Diferencat nga përkthimet valutore	-	-
Dividentat	-	-
Gjendja me 31 Dhjetor 2024	186,665	186,665
Gjendja me 01 Janar 2025	186,665	186,665
Fitimi / (humbja) i/e vitit	79,208	79,208
Diferencat nga përkthimet valutore	-	-
Gjendja 31 Dhjetor 2025	265,872	265,872

Shënimet shpjeguese nga faqe 10 deri në 18 janë pjesë përbërse e këtyre pasqyrave financiare

Pasqyra e Rrjedhjes së Parasë
Periudha 01.01.2025 deri 31.12.2025

	Shënimi	Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025 €	Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2024 €
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Fondi i vitit	9	79,208	114,268
<i>Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave</i>			
Zhvlerësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve		-	-
Dëmtimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve		-	-
Amortizimi i pasurive të paprekshme		-	-
Shpenzimet financiare	8	547	1,028
(Fitimi) / humbja nga shitja e pronës, fabrikës dhe pajisjeve		-	-
Shpenzimet e tatimit në fitim		=	=
		79,755	115,296
<i>Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative:</i>			
Rritja / (zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera		(1)	584
Rritja / (zvogëlimi) në detyrimet e tjera		-	-
		(1)	584
Interesi I paguar	8	(547)	(1,028)
		(547)	(1,028)
Rrjedha neto e parase nga aktivitetet operative		79,207	114,852
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			
Pagesat për blerjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve	2	(54,901)	(172,207)
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese		(54,901)	(172,207)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese			
Deponimet e kapitalit shtesë		-	-
Dividendat e paguara		-	-
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese		-	-
Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë		24,306	(57,355)
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	1	15,042	72,397
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit	1	39,348	15,042

Shënimet shpjeguese nga faqe 10 deri në 18 janë pjesë përbërse e këtyre pasqyrave financiare

1. TË DHËNAT E PËRGJITHSHME

OJQ SHOQATA E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR "HANDIKOS" FERIZAJ është e regjistruar në departamentin e OJQ-ve të Ministrisë së Administratës Publike me datë 06/10/2015 në bazë të nenit 6 Ligjit Nr. 04/L-57. Për Lirinë e Asocimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës. me numër të regjistrimit 5115735-4 dhe numër fiscal 601545166.

Adresa kryesore e OJQ SHOQATA E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR "HANDIKOS" FERIZAJ është:

Ferizaj, Rr.Ramadan Rexhepi nr.01

Numri i personave të angazhuar më 31 Dhjetor 2025 është 12 (2024;11)

POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT

2. OBJEKTIVAT E AUDITIMIT

Qëllim i auditimit ishte, kryerja e të gjitha procedurave, testeve si dhe diskutimeve me këshillin drejtues dhe menagjmentin e këtij entiteti, në lidhje me funksionimin e kontrollit të mbrendshëm, në mënyrë që të jemi në gjendje të japim opinionin tonë mbi Pasqyrat Financiare të përpiluara nga OJQ SHOQATA E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR "HANDIKOS" FERIZAJ e përfshijnë periudhën prej 01.01.2025-31.12.2025, duke mos anashkaluar edhe ngjarjet që kanë ndodhur pas përpilimit të Pasqyrave Financiare, deri në datën e dhënjes së këtij Opinioni.

3. SHTRIRJA DHE METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Gjatë kryerjes së auditimit, duke patur parasysh se kemi pasur qasje të lakmueshme në tërë dokumentacionin financiar, si dhe shumë diskutime me këshillin drejtues dhe stafin e kësaj OJQ-je kemi arritur në mënyrë të kënaqshme të njihemi me procedurat e punës në këtë organizatë.

Gjatë këtij auditimi janë zbatuar procedurat dhe testet thelbësore, duke patur akcentin më të vëmedshëm në këto çështje :

- **Vlerësimi i kualitetit të kontrollit të mbrendshëm**
- **Perfshirja e të hyrave**
- **Përfshirja e shpenzimeve**
-

Është vlerësim i auditorit se Kontrolli i mbrendshëm në OJQ SHOQATA E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR "HANDIKOS" FERIZAJ është në një nivel të lakmueshëm. Një bindje e tillë është arritur nga këto të dhëna :

* Në OJQ SHOQATA E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR "HANDIKOS" FERIZAJ menaxhon këshillin drejtues, duke u kujdesur që edhe keqpërdorimet eventuale të evitohen në minimum.

* Pjesa dërmuese e transaksioneve financiare janë kryer përmes xhirollogarisë bankare në Banken Ekonomike.

POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

4. Baza e pregaditjes dhe përmbledhja e politikave të zbatuara në kontabilitet

Pasqyrat Financiare të OJQ SHOQATA E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR "HANDIKOS" FERIZAJ me adresë në Ferizaj, Rr.Ramadan Rexhepi nr.01 për vitin 2025 janë përpiluar në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Me këtë rast biznesi ka paraqitur të përpiluara me sa vijon :

- Pasqyrën e pozicionit financiar,
- Pasqyrën gjithëpërfshirëse të të hyrave dhe të dalave,
- Pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet,
- Pasqyrën e rrjedhjes së parasë dhe fitimit të mbajtur,
- Shpalosjet.

Nuk ka patur vështirësi specifike me rastin e përpilimit të këtyre pasqyrave, janë regjistruar të gjitha transaksionet financiare.

5. Prezentimi I Pasqyrave Financiare

Pasqyrat Financiare të OJQ-ës, janë prezentuar me vlera të plota numerike dhe atë në valutën që është në përdorim në Republikën e Kosovës (EUR).

6. Përpilimi I Pasqyrave Financiare

Pasqyrat Financiare të OJQ SHOQATA E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR "HANDIKOS" FERIZAJ me adresë në Ferizaj, Rr.Ramadan Rexhepi nr. 01 për vitin 2025 janë përpiluar në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Në raste të caktuara OJQ-ja ka përshtatur kontabilitetin e saj me rregulloret aktuale tatimore dhe rregulloreve të veprimit të OJQ, në Republikën e Kosovës.

7. Përmbledhje e politikave të kontabilitetit

Organizata ka një plan kontabël I cili shërben për llogarimbajtjen e të gjitha transaksioneve financiare dhe aktiviteteteve tjera që kryen organizata në fjalë.

- Politikat e kontabilitetit janë të bazuara në parimin akrual të regjistrimeve

POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

8. Valuta huaj

OJQ SHOQATA E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR "HANDIKOS" FERIZAJ me adresë në Ferizaj, Rr.Ramadan Rexhepi nr. 01, gjatë vitit 2025 nuk ka patur transaksione financiare në valutë të huaj.

9. Pasuritë qarkulluese

9.1. Paraja

Paraja është paraqitur në shumën prej: 39,348 EUR, dhe ka këtë strukturë :

- Në llogari rrjedhese në bankë: 39,348 EUR

9. DETYRIMET

Nuk janë raportuar në pasqyra obligime të pakryera nga ana e OJQ SHOQATA E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR "HANDIKOS" FERIZAJ.

10.1. Menaxhimi I rrezikut

Është mendim I yni se OJQ SHOQATA E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR "HANDIKOS" FERIZAJ. dhe stafi I saj profesional ka arritur të menaxhojë me mjetet – donacionet dhe se ato janë shpenzuar sipas projekteve dhe sipas destinacionit të dedikuar.

- Jane identifikuar te gjitha të hyrat nga donacionet, të cilat janë derdhur në konton e OJQ SHOQATA E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR "HANDIKOS" FERIZAJ në Bankën Ekonomike të Kosovës dhe BKT.
- Të gjitha shpenzimet si më lartë kanë të bëjnë me aktivitetin e OJQ-ës, siq janë organizimi I turneve të ndryshme dhe aktivitetet të tjera në domenin e veprimtarisë së regjistruar të OJQ SHOQATA E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR "HANDIKOS" FERIZAJ.
- Në shpenzimet e transportit janë përfshirë, shpenzimet me rastin e transportit të aktivistëve, pastaj pjesëmarrja nëpër konferenca, simpoziume etj.

10. RREZIKU I LIKUIDITETIT

Gjatë vitit 2025, OJQ SHOQATA E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR "HANDIKOS" FERIZAJka arritur të ruaj aftësinë likuide duke shpenzuar të gjitha donacionet e marra, dhe shpërndarjen dhe shpenzimin e tyre sipas planifikimeve dhe projekteve programore, për çka edhe është themeluar.

POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)**12. TATIMET****12.1 Tatimi në vlerën e shtuar****RREZIKU I LIKUIDITETIT**

Gjatë vitit 2025, OJQ SHOQATA E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR "HANDIKOS" FERIZAJ nuk është biznes fitim prurës dhe për këtë arsye nuk i nështrohen obligimeve për tatim fitim po ashtu edhe për Tatim mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), duke mos patur të drejtën as të rimbursimit të (TVSH).

13.2 Tatimet dhe kontributet për pension

OJQ-ja ka paraqitur 12 puntorë në listën e pagave në muajin Dhjetor/2025, të cilët kanë qënë të kyqyr si antarë të organizatës, përfshirë edhe personat që angazhohen kohë pas kohe në aktivitetet e OJQ.

	Më 31.12. 2025	Më 31.12. 2024
	EURO	EURO
1. Paraja në bankë		
BEK	35,936	14,125
BKT	3,412	917
Toali I parasë nga bankat	39,348	15,042
Gjithsej paraja në arkë dhe bankë	39,348	15,042

2. Prona, impiantet dhe paisjet	Ndërtesat	Investime në vijim	Totali/EURO
KOSTO			
Më 1 Janar 2025	172,207	-	172,207
Blerjet gjate vitit	54,901	-	54,901
Shlyerjet-kthimet	-	-	-
Më 31 Dhjetor 2025	227,108	-	227,108
ZHVLERËSIMI			
Më 01 Janar 2025	-	-	-
Zhvlërësimi për vitin	-	-	-
Eliminimet në shlyerje	-	-	-
Më 31 Dhjetor 2025	-	-	-
VLERA E BARTUR NETO			
Më 31 Dhjetor 2025	227,108	-	227,108
Më 1 Janar 2025	172,207	-	172,207

SHËNIMET E SHPALOSURA TË PASQYRAVE FINANCIARE

	Më 31.12. 2025	Më 31.12. 2024
	EURO	EURO
3. Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera		
Furnitor vendor	583	584
Gjithsej	583	584

	Më 31.12. 2025	Më 31.12. 2024
	EURO	EURO
4. Fondet e mbajtura		
Fondet e bartura nga vitet e kaluara	186,665	72,397
Fondi i vitit	79,208	114,268
Gjithsej	265,872	186,665

	Më 31.12. 2025	Më 31.12. 2024
	EURO	EURO
5. Të hyrat nga donacionet		
Të hyrat nga donacionet	36,287	24,466
Të hyrat nga Institucionet	54,947	1900
Të hyrat nga DRKS 1-2	-	3,595
Të hyrat nga MD	-	5,250
Të hyrat programore	4,453	9,605
Të hyrat tjera	1,800	2,112
Të hyrat nga MKRS	-	7,000
Të hyrat nga MD 2024	-	20,000
Gjithsej	97,487	73,928

	Më 31.12. 2025	Më 31.12. 2024
	EURO	EURO
6. Të hyrat tjera		
Të hyrat nga donacionet per objekt	58,899	129,096
Gjithsej	58,899	129,096

SHOQATA E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR "HANDIKOS" FERIZAJ me 31 Dhjetor 2025

	Më 31.12. 2025	Më 31.12. 2024
	EURO	EURO
7. Shpenzimet administrative		
Shpenzimet e pagave	51,423	44,901
Shpenzimet e tatimit në burim	2,024	2,009
Shpenzimet e kontributeve	5,110	5,707
Shpenzimet e kontraktuara	-	5,500
Shpenzimet e zyres	283	649
Shpenzimet e furnizimeve tjera	800	1,711
Shpenzimet e konferencave, tyeza, puntori	980	8,159
Shpenzimet e promovimeve	1,199	6,788
Shpenzimet e Ueb faqës	150	60
Shpenzime telefonit dhe internetit	646	769
Shpenzimet e transportit	1,841	2,060
Shpenzimet e qerasë	2,552	1,908
Shpenzimet e komunale	342	886
Shpenzimet e mirmbajtje dhe riparime	257	1,413
Shpenzimet e energjise elektike	306	-
Shpenzimet e trajnimeve	51	-
Shpenzimet e materialeve	8,249	-
Shpenzimet e pastrimit	-	2,335
Shpenzimet tjera	420	2,873
Gjithsej	76,631	87,728

	Më 31.12. 2025	Më 31.12. 2024
	EURO	EURO
8. Shpenzimet financiare		
Shpenzimet e kamatave dhe provizioneve	547	1,028
Gjithsej	547	1,028

	Më 31.12. 2025	Më 31.12. 2024
	EURO	EURO
9. Shpenzimet e tatimit në fitim		
Fitimi I vitit para tatimit	79,208	114,268
Fitimi për vitin pas shpenzimeve të pa-zbritshme	79,208	114,268
Tatimi I mbajtur në burim	-	-
Fitimi Neto	79,208	114,268

14. Detyrimet kontigjente dhe zotimet

Më 31 Dhjetor 2025 nuk ka detyrime kontingjente të cilat kërkojnë shpalosje në pasqyrat financiare të OJQ-ës.

Procedimet gjyqësore

Deri me 31 Dhjetor 2025 OJQ-ja nuk ka iniciuar procedura gjyqësore ndaj organizatave të tjera.

15. Ngjarjet pas datës së raportimit

Pas 31 Dhjetorit 2025 dhe data raportuese deri në miratimin e këtyre raporteve financiare nuk ka ndonjë ngjarje për tu shpalosur në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare të OJQ SHOQATA E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR "HANDIKOS" FERIZAJ.